



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 2957 Prot

Elbasan më 10.3.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.22, datë 26.02.2025 “Përdorim fondi rezervë për “ Blerje, zhvillim, prodhim ose bashkëprodhim i materialeve të synuara për shërbime të medias audiovizive ose shërbime të medias radiofonike në bashkinë Librazhd me natyrë arsimore, kulturore dhe dhe infrastrukturore”, referuar vendimit nr 9, datë 24.12.2020, “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelles dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, të Komisionit Qendror të zgjedhjeve si dhe Udhëzuesi nr 15, datë 15.01.2025 “Për unifikimin e zbatimit të ligjit për nënpunësin civil në drejtim të zhvillimit të procesit të rekrutimit gjatë periudhës zgjedhore, pjesmarrjes së nënpunësve civilë në institucionet e administrimit të procesit zgjedhor, respektimit të të drejtave të tyre politike e detyrimeve ligjore, ndërveprimin e nënpunësve civilë me platformat apo rrjetet sociale që shfaqen për publikun ndërmjet internetit, për të shmangu propagandën elektorale, si dhe masat që duhet të marrin institucionet për të monitoruar situatën, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj, dhe ju rekomandojmë zbatimin e efekteve financiare dhe ekonomike të këtij vendimi pas datës 11 Maj 2025.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.28.02.2025

Nr.1209 prot

Nr.22 dt.26.02.2025

“Përdorim fondi rezervë për

“Blerje ,zhvillim,prodhim ose bashkëprodhim i materialeve të synuar për shërbime të medias audiovizive ose shërbime të medias radiofonike për bashkinë Librazhd me natyrë arsimore ,kulturore dhe infrastrukturore”

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 Datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore “, të Ligjit Nr.9936 Datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë “ , i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr.115/2024“Për Buxhetin e vitit 2025” ,Udhezimi plotësues nr.2 date 24.01.2025 “Per zbatimin e buxhetit te vitit 2025”, Këshilli Bashkiak i mbledhur sot më datë 26.02.2025 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI :

1. Te miratoje kerkesen per Blerje ,zhvillim,prodhim ose bashkëprodhim i materialeve të synuar për shërbime të medias audiovizive ose shërbime të medias radiofonike për bashkinë Librazhd me natyrë arsimore ,kulturore dhe infrastrukturore ne vleren 500,000 leke.
2. Per sigurimin e ketyre fondeve te miratoje ndryshimet buxhetore si me poshte :

Pakesim

Grupi	Tit.	Kap.	Art .	Vlera ne leke
00	4910	01	609	500,000 leke Fond Rezervë .

Shtese

Grupi	Tit.	Kap.	Art .	Vlera ne leke
00	1110	01	602	500,000 leke Blerje ,zhvillim,prodhim ose bashkëprodhim i materialeve të synuar për shërbime të medias audiovizive ose shërbime të medias radiofonike për bashkinë Librazhd me natyrë arsimore ,kulturore dhe infrastrukturore

3. Ndjek zbatimin e ketij vendimi Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar , ,Sektori Juridik.
4. Ky vendim hyne ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

ZV/KRYETARE E KËSHILLIT
Silvana HOXHA

